VENDIM
Nr.956, datë 24.11.2010

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË SHKODRËS TË PRONËS NR.373 "*REPARTI USHTARAK NR.1150*", NË TEPE, SHKODËR, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

(Ndryshuar me Vendimin nr. 275, datë 6.4.2011)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja "c", 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë së Shkodrës të pronës nr.373 "*Reparti ushtarak nr.1150*", në Tepe, Shkodër, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për ta përdorur për realizimin e programeve mësimore, ndërtim shkolle, objekte sociale, kulturore, sportive dhe të shëndetit publik, në qytetin e Shkodrës.
2. Prona nr.373, me emërtesë "*Reparti ushtarak nr.1150*", në Tepe, Shkodër, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Bashkisë së Shkodrës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
4. Dorëzimi i kësaj prone të bëhet pas heqjes së materialeve dhe të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të cilat janë depozituar në këtë pronë.
5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, kryetari i bashkisë së Shkdorës, si dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha